

VENDIM
Nr. 17, datë 29.6.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare
Marsida Xhaferllari	anëtare
Fiona Papajorgji	anëtare
Altin Binaj	anëtar
Sonila Bejtja	anëtare
Sandër Beci	anëtar
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 29.6.2022, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 2 (B) 2022 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: BARDHYL IBRA

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR,

MINISTRIA E DREJTËSISË,

SULEJMAN KURTI.

OBJEKTI: shfuqizimi i vendimit nr. 13/19/11, datë 16.9.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm si në Gjykatën Administrative të Apelit, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë.

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: nenet 42, 43, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës; nenet 6/1 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 399/1 e vijues të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*); ligji nr. 98/2016, datë 6.10.2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligji nr. 49/2012, datë 3.5.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e çështjeve administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi parashtrimet e kërkuarit Bardhyl Ibra, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Lartë Gjyqësor (*KLGJ*) dhe Ministrisë së Drejtësisë, që kërkuar rrëzimin e kërkesës, parashtrimet e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, i cili në thelb kërkoi zëvendësimin procedural të tij, konstatoi mungesën e parashtrimeve me shkrim të subjektit Sulejman Kurti, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuar i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt: “1. Detyrimin e KLD për fillimin e procedurave administrative për marrjen e masave disiplinore për

kryetarin e gjykatës Sulejman Kurti për shpërdorim të detyrës dhe veprime të tjera korruptive e arbitrare, përveç të tjerave dhe për ngjarjen e datës 27.6.2017, i cili më nxori jashtë gjykate gjoja se unë nuk lejobem. 2. Sigurim prove, duke marrë deklaratimet e kancelarit L.S., njoftuesit të gjykatës zotit S.Gj., nëpunësit të sigurisë M.C., sekretares gjyqësore K.B. e policit të rendit, turn i parë. 3. Të bëhet sigurimi i provës, duke marrë filmimet e marra nga kamerat e korridoreve nga ora 08:00 deri në orën 10:00 të datës 27.6.2017. 4. Si provë të merret shkresa nr. 11123 prot., datë 14.6.2017, së bashku me kopjen e kërkesës sime datë 13.6.2017 e kërkesës datë 2.5.2017, pasi ka rrezik të zhduket për t'i shpëtuar përgjegjësisë penale.”.

2. Me vendimin nr. 3710, datë 3.10.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur t'i kthejë kërkuarit padinë administrative nr. 4437 akti, së bashku me aktet bashkëlidhur saj, për shkak të mosplotësimit të të metave brenda afatit ligjor të përcaktuar.

3. Kërkuar ka paraqitur ankim të veçantë ndaj vendimit nr. 3710, datë 3.10.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31138-06137-86-2017 akti, datë 20.12.2017.

4. Në kushtet kur ankimi i tij drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit nuk ishte shqyrtuar ende, në datën 11.12.2019 kërkuar i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë me objekt: *“Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të parashikuar nga shkronja “a” e nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile; neni 48, pika 2, i ligjit nr. 49/2012, datë 3.5.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të çështjes administrative të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31138-06137-86-2017, datë 20.12.2017 dhe detyrimin e kësaj gjykate për përshpejtimin e gjykimit të çështjes. Marrja e informacionit të nevojshëm për këtë çështje nga ana juaj kësaj gjykate në bazë të nenit 399/4, paragrafi i parë, i Kodit të Procedurës Civile.”.*

5. Me vendimin nr. 13/19/11, datë 16.9.2021, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit.

6. Në datën 14.12.2021 kërkuar i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda një afati të arsyeshëm, si dhe shfuqizimin e vendimit nr. 13/19/11, datë 16.9.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.

7. Me vendimin e datës 15.3.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

8. Nga viti 2019 e deri në datën e shqyrtimit të kësaj çështjeje, kërkuar ka paraqitur për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese 61 kërkesa, përfshirë edhe atë për çështjen konkrete. Për 51 prej tyre kolegjet ose Mbledhja e Gjyqtarëve të kësaj Gjykate ka vendosur moskalimin për shqyrtim në seancë plenare, ndërsa për 1 kërkesë Gjykata është shprehur me vendim përfundimtar. Po sipas të dhënave të kësaj Gjykate, deri në datën e seancës për gjykimin e këtij ankimi kushtetues, 8 kërkesa të kërkuarit janë në fazën e shqyrtimit paraprak nga kolegjet e Gjykatës.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. Kërkuar ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

9.1 *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka shqyrtuar ende çështjen e tij, ndonëse janë tejkaluar afati 30-ditor, i parashikuar në nenin 48 të ligjit nr. 49/2012 dhe ai 1-vjeçar i përcaktuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së. Po kështu, kërkesa e tij për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave është gjykuar nga Gjykata e Lartë tej afatit 45-ditor të parashikuar nga neni 399/7, pika 2, i KPC-së.

9.2 *E drejta e aksesit*, pasi gjykatat nuk kanë zgjidhur ende në themel çështjen e tij.

9.3 *Parimi i sigurisë juridike*, pasi gjykatat nuk kanë dhënë vendime brenda afateve të përcaktuara nga ligjet përkatëse.

9.4 *E drejta për dëmshpërblim*, pasi rivendosja e së drejtës së saj të shkelur mund të bëhet vetëm përmes dëmshpërblimit dhe kthimit të çështjes për rigjykim.

10. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka prapësuar me shkrim, duke kundërshtuar pretendimet e kërkuarit si vijon:

10.1 Kërkuari nuk e ka shfrytëzuar mjetin ligjor në dispozicion të tij në referim të nenit 460, pika 3, të KPC-së, pasi nuk ka iniciuar procedurën për gjykimin e përshpejtuar të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit.

10.2 Tejzgjatja e procedurave nuk paraqet një shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkuarit. Çështja nuk është e tillë që, për shkak të natyrës së saj, të ketë përparësi në radhën e shqyrtimit.

10.3 Nuk ka shkelje të së drejtës për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, pasi zgjatja e afatit është pasojë e faktorëve objektivë të njohur tashmë, si reforma në drejtësi dhe procesi i vetingut. Mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator.

11. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka prapësuar me shkrim, duke kundërshtuar pretendimet e kërkuarit si vijon:

11.1 Kërkuari ka ndikuar në vonesën e procesit gjyqësor, pasi nuk i ka kushtuar kujdesin e duhur plotësimin në kohë të të metave të padisë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe depozitimit në kohë të dokumenteve dhe provave.

11.2 Natyra e interesave të përfshira në çështjen e kërkuarit nuk rezulton të jetë emergjente, e tillë që duhet trajtuar me përparësi nga gjykata.

11.3 Vonesa e gjatë në shqyrtimin e çështjes është rrjedhojë e një problematike të njohur tashmë, reformës në drejtësi dhe procesit të vetingut.

11.4 Mekanizmi zhbllokues i parashikuar në nenet 399/1-399/12 të KPC-së përjashtohet nga zbatimi në rastet e pamundësisë objektive për procedim. Këto nene kanë krijuar një mekanizëm efektiv për kohë të zakonshme të veprimtarisë gjyqësore, ku synimi parësor nuk është dëmshpërblimi monetar i palëve në proces, por parandalimi i tejzgjatjes së procesit përmes mekanizmave përshpejtues, me qëllim dhënien e drejtësisë në kohë nga gjykatat.

11.5 Kërkuari po shfrytëzon mekanizmat ligjorë në dispozicion të tij jo për zgjidhjen e çështjes së themelit, por për të krijuar përfitime, duke krijuar një praktikë abuzive.

12. Subjekti i interesuar, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, ka prapësuar me shkrim se pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2016 dhe riorganizimit të institucioneve qeverisëse të sistemit të drejtësisë nuk rezervon të drejtat e kryetarit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për rrjedhojë duhet bërë zëvendësimi procedural i tij.

13. Subjekti i interesuar, Sulejman Kurti, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

14. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134 pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar

në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Gjykata vëren se kërkuesi, në thelb, pretendon gjykimin përtej afatit të arsyeshëm të çështjes së tij në Gjykatën Administrative të Apelit, i cili ende nuk ka përfunduar, duke kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën e tij për përshpejtimin e procedurave. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkuesi ka pretenduar se mjeti juridik, kërkesa për përshpejtim, nuk ka qenë efektiv në rastin e tij, pasi vendimi për këtë kërkesë është dhënë nga Gjykata e Lartë pas rreth 1 viti e 9 muajsh, në kundërshtim me nenin 399/7, pika 2, të KPC-së që parashikon afatin 45-ditor për shqyrtimin e saj, si dhe ka kërkuar dëmshpërblim për këtë shkak.

16. Për sa i takon thelbit të pretendimeve të kërkuetit, Gjykata vëren se objekt i ankimit kushtetues individual është ecuria e gjykimit të kërkesës së tij për fillimin e procedurave administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj ish-kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, gjykim i cili është duke u zhvilluar në Gjykatën Administrative të Apelit.

17. Për sa më lart, Gjykata vëren se objekti i kërimit në gjykatën e shkallës së parë ka qenë marrja e masave disiplinore ndaj ish-kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Me vendimin nr. 3710, datë 3.10.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur t'i kthejë kërkuetit padinë administrative së bashku me aktet bashkëlidhur saj, për shkak të mosplotësimit të të metave brenda afatit ligjor të përcaktuar. Kërkuesi ka paraqitur ankim të veçantë ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31138-06137-86-2017 akti, datë 20.12.2017 dhe, në vijim, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit dhe përshpejtimin e gjykimit të çështjes së tij.

18. Gjykata vëren se sipas shkresës nr. 935/1 prot., datë 14.6.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit, kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesë para asaj gjykate për përshpejtimin e çështjes në zbatim të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit", por i është drejtuar Gjykatës së Lartë në përputhje me nenin 399/1 e vijues të KPC-së. Me vendimin nr. 13/19/11, datë 16.9.2021, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Sipas nenit 399/8 të KPC-së, ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

19. Në këto kushte, Gjykata vëren se kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "P", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000. Po ashtu, Gjykata thekson se, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, shqyrtimi i kërkesës për dëmshpërblim nuk bën pjesë në juridiksionin e saj, prandaj kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* në këtë drejtim (*shih vendimin nr. 13, datë 26.5.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga ana tjetër, në kërkesën drejtuar Gjykatës, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit i ka cenuar të drejtën e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e tejzgjatjes së procedurave të gjykimit.

21. Subjekti i interesuar, KLGJ-ja, ka parashtruar se kërkuesi nuk e ka shfrytëzuar mjetin ligjor në dispozicion të tij në referim të nenit 460, pika 3, të KPC-së, pasi nuk ka iniciuar procedurën për gjykimin e përshpejtuar të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit dhe se në rastin e tij nuk ka shkelje të së drejtës për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, pasi zgjatja e afatit është pasojë e faktorëve objektivë të njohur, si reforma në drejtësi dhe procesi i vetingut. Mosveprimi i gjykatës nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator.

22. Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë, ka parashtruar se kërkuesi ka ndikuar në vonesën e procesit gjyqësor, pasi nuk i ka kushtuar kujdesin e duhur plotësimit në kohë të të metave të padisë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe depozitimit në kohë të dokumenteve dhe provave. Po sipas këtij subjekti, vonesa e gjatë në shqyrtimin e çështjes

është rrjedhojë e një problematike të njohur tashmë, reformës në drejtësi dhe procesit të vettingut. Për më tepër, mekanizmi zhblllokues i parashikuar në nenet 399/1-399/12 të KPC-së përjashtohet nga zbatimi në rastet e pamundësisë objektive për procedim. Këto nene kanë krijuar një mekanizëm efektiv për kohë të zakonshme të veprimtarisë gjyqësore, ku synimi parësor nuk është dëmshpërblimi monetar i palëve në proces, por parandalimi i tejzgjatjes së procesit përmes mekanizmave përshpejtues, me qëllim dhënien e drejtësisë në kohë nga gjykatat. Kërkuesi po shfrytëzon mekanizmat ligjorë në dispozicion të tij jo për zgjidhjen e çështjes së themelit, por për të krijuar përfitime, duke krijuar një praktikë abuzive.

23. Gjykata rritet se e drejta për proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, garantohet nga neni 42 i Kushtetutës dhe se kjo e drejtë luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (*shih vendimet nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Në vlerësimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos: i) sjelljen e kërkuarit; ii) kompleksitetin e çështjes; iii) sjelljen e autoriteteve; iv) si dhe çfarë përbën rrezik për kërkuarin (*shih vendimet nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 34, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Gjykata konstaton se nga dokumentet bashkëlidhur kërkesës dhe parashtrimet e paraqitura me shkrim nga kërkuari nuk rezulton që ai të ketë plotësuar të metat dhe riparuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesëpadinë e tij fillestare, pas kthimit të saj pa veprim së bashku me aktet, por ka zgjedhur të ankimojë vendimin e saj, duke ndikuar në këtë mënyrë në zvarritjen e zgjidhjes së themelit të çështjes, për të cilën ka vënë në lëvizje pushtetin gjyqësor. Për më tepër, kërkuari ka vazhduar procedurat për gjykimin e çështjes së kthimit të kërkesës pa veprim nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pavarësisht se ish-kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ndaj të cilit ka kërkuar fillimin e procedurave administrative për marrjen e masave disiplinore, është shkarkuar nga organet e vettingut me vendimin e datës 6.11.2019.

26. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se në ankimin kushtetues individual kërkuari nuk ka arritur të provojë interesin e tij të drejtpërdrejtë dhe individual për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

27. Në përfundim, Gjykata çmon se kërkesa e kërkuarit duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 29.6.2022

Shpallur më 29.7.2022

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Elsa Toska, Sandër Beci